

PYETJET E HISTORISE SE ARTIT

Departamenti i Pikturës

Pyetjet janë të ndara në numra rendor dhe çdo numër përmban tre nënpyetje:

a - Nga historia e artit botëror

b – Nga historia e artit shqiptar

c - Nga specialiteti i zgjedhur

Pyetjet shërbejnë për njërën nga fazat e konkursit të pranimin të studentëve në Universitetin e Arteve, Fakulteti i Arteve të Bukura. Krahas konkurimit praktik në pikturë, skulpturë dhe vizatim, studenti testohet edhe teorikisht për njohuritë e tij rreth Historisë së Artit botëror, shqiptar me specifikisht mbi specialitetin e përzgjedhur.

Pyetjet shërbejnë si një orientim fillestar në bashkëbisedim. Anëtarët e komisionit kanë të drejtë të bëjnë dhe pyetje shtesë kur ata e shohin të nevojshme.

Secili student tërheq pyetjet dhe përgjigjet në prani të komisionit. Studenti ka të drejtë të tërheqë pyetjet deri në dy herë.

PYETJET PËR ATELIERIN E PIKTURËS SË KAVALETIT:

Teza I

- a)** Historia e Artit ndahet në periudha. Citoni në mënyrë kronologjike ato, nga Prehistoria e deri në ditët tona. Përse është e domosdoshme njohja e Historisë së Artit për një student të Universitetit të Artit?
- b)** Flisni mbi jetën dhe veprën e piktorit Zef Kolombi. Komentoni mbi ndonjë vepër të njohur të tij.
- c)** Flisni mbi marrëdhënien e fotografisë me pikturën dhe anasjelltas.

Teza II

- a)** Flisni mbi Egjiptin e lashtë, konteksti gjeografiko-historik dhe tiparet thelbësore të artit egjiptian. Si caktoheshin dhe zbatoheshin kanonet e artit egjiptian? Jepni ndonjë shembull konkret dhe komentoni rreth tij.
- b)** Çfarë mund të thoni mbi krijimtarinë artistike të piktorit Abdurrahim Buza? Cila është tema qendrore e tij? Merrni e komentoni një vepër të tij.
- c)** Çfarë dini mbi pikturën digjitale? Çfarë mangësish e përparësish mund të ketë ajo në marrëdhënie me pikturën tradicionale?

Teza III

- a)** Përshkruani dhe nxirrni në pah ndryshimet ndërmjet Kanonit artistik Egjiptian dhe Kanonit artistik Grek? A ndikoi organizimi politik, shoqëror dhe fetar në krijimin e këtyre kanoneve?
- b)** Kur u shfaq metoda e “Realizmit Socialist” në Shqipëri? Çfarë tiparesh shfaqte kjo metodë? Komentoni ndonjë vepër tipike të Realizmit socialist shqiptar.
- c)** Flisni mbi ndryshimet e fotografisë analoge prej asaj digjitale si proces realizimi dhe përhapjeje.

Teza IV

- a)** Flisni mbi temën qendrore (përmbajtjen) dhe tiparet e artit Bizantin. Citoni disa dëshmi artistike të artit Bizantin, në arkitekturë, skulpturë, pikturë.
- b)** Çfarë mund të thoni mbi piktorin Vangjush Mio. Cila është gjinia artistike ku spikat më tepër personaliteti i tij? Komentoni një vepër të tij.
- c)** Flisni mbi një fotograf bashkohor dhe krijimtarinë e tij.

Teza V

- a)** Flisni çfarë dini mbi qytetërimin dhe artin gotik. Komentoni mbi disa vepra të rëndësishme gotike në arkitekturë, skulpturë dhe pikturë.
- b)** Citoni emrat e shtatë (7) artistëve të arteve pamore në Shqipëri. Flisni më gjerësisht për njërin prej tyre.
- c)** Çfarë është teknika 'sfumato-s'? Kush e përdori atë dhe për të arritur çfarë rezultatesh?

Teza VI

- a)** Flisni mbi Rilindjen Italiane, fazat e zhvillimit të saj dhe autorët përfaqësues. Analizoni një vepër të njohur të Rilindjes.
- b)** Flisni mbi ndonjë piktor të artit bizantin në Shqipëri. A mund të flisni mbi ndonjë muze të Shqipërisë ku ruhen dhe ekspozohen koleksione ikonash?
- c)** Çfarë dini mbi teknikën e kolazhit? A mund të gjeni një vepër ku është përdorur?

Teza VII

- a)** Kush është autori i skulpturës "Pieta" që gjendet në Vatikan? Prej nga është marrë tema e kësaj vepre dhe çfarë trajton ajo? Përmendni disa vepra të rëndësishme të këtij autori.
- b)** Flisni mbi ardhjen dhe zhvillimin e fotografisë në Shqipëri.
- c)** Çfarë dini mbi teknikën piktorike të pastelit dhe cilësitë dhe rezultatet e tij në krahasim me teknikat e tjera?

Teza VIII

- a)** Flisni përmbi ndonjë përfaqësues të Rilindjes në Vendet e Ulëta dhe Gjermani dhe përmbi ndonjë vepër të tyre.
- b)** Cilët janë fotografët Marubi. Vlera e punës së tyre.
- c)** Çfarë dini mbi teknikën piktorike të akuarelit dhe cilësitë e saj në krahasim me teknikat e tjera?

Teza IX

- a)** Flisni mbi çka dini rreth jetës dhe krijimtarisë së piktorit Caravaggio. Analizoni një vepër të tij.
- b)** Citoni një vepër të artit pamor shqiptar që ju ka lënë më shumë mbresë dhe bëni një koment rreth saj.
- c)** Përshkruani disa mënyra pikturimi brenda teknikës së ngjyrave të vajit (pastroze, velatura, etj) duke e konkretizuar këtë gjë në veprën e piktorëve të ndryshëm

Teza X

- a)** Përmendni disa nga veprat më të rëndësishme të piktorit Diego Velasques. Çfarë ju bën përshtypje në veprën e tij? Komentoni mbi një vepër të tij.
- b)** Cili është autori i shtatores së Fan Nolit pranë Akademisë së Shkencave në Tirane? Flisni rreth saj.
- c)** A mund të flisni për ndryshimet që ka pësuar në përmbajtje dhe në formë arti i periudhës 1990 e deri më sot në krahasim me artin e periudhës 1944-1990?

Teza XI

- a)** Cilat janë temat që trajton piktori J. F. Millet? Në cilën gjini të artit krijoi piktori H. Domie? Flisni mbi temat e trajtuara nga Gustave Courbet
- b)** Kujt periudhe i takon “Epitafi i Gllavenicës” dhe në cilin muze ruhet sot? A mund ta përshkruani këtë vepër?
- c)** Flisni mbi teknikën piktorike të ngjyrave të vajit dhe cilësitë e saj në krahasim me teknikat e tjera.

Teza XII

- a)** Çfarë dini mbi Postimpresionizmin? Përmendni përfaqësuesit e tij dhe flisni gjerësisht mbi jetën dhe veprën e njërit prej tyre.
- b)** Citoni tre vepra të skulptorit Odhise Paskali dhe analizoni njerën prej tyre.
- c)** Flisni çfarë dini mbi teknikën e Neoimpresionizmit të quajtur puantilizëm (pointillisme). Si realizohej kjo teknikë piktorike dhe me çfarë synimesh dhe rezultatesh?

Teza XIII

- a) Çfarë përfaqson Kubizmi? Citoni emrat e dy piktorëve kubistë. Cila është vepra e parë që zyrtarisht u etiketua kubiste?
- b) Na thoni ndonjë ekspozitë të arteve pamore që ke vizituar në Shqipëri dhe flisni gjerësisht rreth saj.
- c) Flisni çfarë dini mbi gjininë e karikaturës dhe mbi ndonjë përfaqësues të saj në vendin tonë.

Teza XIV

- a) Flisni mbi Artin informal gjestual (action painting) dhe atë materik. Prirje dhe autorë.
- b) Çfarë dini rreth fotografit Gjon Mili? Ku u zhvillua vepra e tij dhe çfarë risish kishte ajo për kohën?
- c) Çfarë dini mbi teknikën piktorike të temperas dhe cilësitë e saj në krahasim me teknikat e tjera?

Teza XV

- a) Flisni çfarë dini mbi platformat e Artit Minimal si dhe Konceptual. Çfarë ndryshoi në statusin e veprës së artit?
- b) Çfarë dini mbi fotografinë në zonën e Korçës, Dardhës dhe Pogradecit? A mund të flisni për fotografët e këtij rajoni?
- c) Flisni mbi elementet e pikturës dekorative dhe asaj natyraliste.

Teza XVI

- a) A mund të flisni rreth prirjeve që kishte piktura mbas viteve 1980: Transavanguardia (Itali), Neoekspresionizmi (Gjermani), Grupimi Co.Br.A?
- b) A njihni ndonjë grafist shqiptar. Citoni dhe flisni për njërin.
- c) Flisni mbi elementet e pikturës dekorative dhe asaj realiste

PYETJET PËR ATELIERIN E PIKTURËS SË APLIKUAR (MONUMENTALE):

Teza I

- d)** Çfarë dini mbi artin prehistorik, periudhat e zhvillimit të tij dhe tiparet që mbart?
- e)** Flisni mbi jetën dhe veprën e Kol Idromenos. Analizoni e komentoni pikturën e tij “Motra Tone”.
- f)** Çfarë qëllimi pati piktura monumentale në arkitekturën religjioze? Përmendni një autor?

Teza II

- a)** Përmendni disa nga veprat artistike më të rëndësishme të artit klasik Grek, në arkitekturë, skulpturë, pikturë. Pse u quajt “Klasike” dhe në ç’periudhatë tjera të mëvonshme pati ndikim të dukshëm?
- c)** Flisni mbi përmbajtjen dhe stilin e mozaikut në fasadën e “Muzeut Historik Kombëtar” në Tiranë? Cilët janë autorët e saj?
- d)** Çfarë dini mbi teknikën e vitrazhit? Si lidhet kjo teknikë me arkitekturën?

Teza III

- a)** Citoni disa nga dëshmitë më të rëndësishme artistike të artit Romak, në arkitekturë, skulpturë, pikturë dhe ndaluni e komentoni më gjerësisht një të një prej tyre.
- b)** A njihni jetën e veprën e ndonjë artisti shqiptar që ishte i mënjanuar apo persekutuar gjatë regjimit komunist? Flisni mbi to.
- a)** Flisni mbi një vepër të pikturës murale në Shqipëri.

Teza IV

- a)** Flisni çfarë dini mbi qytetërimin dhe artin romanik. Kontekstin historik të zhvillimit të tij. Komentoni mbi disa vepra të rëndësishme romanike në arkitekturë, skulpturë dhe pikturë.
- b)** Çfarë dini mbi piktorin Spiro Xega dhe veprën e tij? Komentoni një vepër të tijën.
- c)** Kujt i përkushtohet arti etrusk?

Teza V

- a)** Një periudhë në historinë e artit u quajt “Rilindje”. Pse u quajt kështu? Ku lindi fillimisht dhe ku u shfaq më pas ajo?
- b)** Flisni mbi një artist bashkëkohor shqiptar që njihni. Analizoni ndonjë prej veprave të tij.
- c)** Çfarë është mozaiku? Çfarë dini mbi teknikën dhe procedurën e realizimit të tij?

Teza VI

- a) Kush është autori i pikturës murale “Darka e fundit”? Ku ndodhet ajo? Prej nga është marrë tema e kësaj vepre dhe çfarë trajton ajo? Përmendni disa vepra të rëndësishme të këtij autori.
- b) Flisni mbi një piktor të artit pamor shqiptar të para viteve 1944. Komentoni mbi një vepër të tij.
- a) Flisni mbi afreskun dhe teknikat e realizmit të tij.

Teza VII

- a) Kush është autori i pikturës murale “*Shkolla e Athinës*”? Ku ndodhet kjo vepër? Çfarë trajtohet në këtë vepër? Përmendni disa vepra të rëndësishme të këtij autori.
- b) Flisni mbi krijimtarinë e ndonjë artisti bashkëkohor shqiptar që jeton jashtë atdheut.
- c) Flisni mbi teknikat e pikturës romake. Përshkruani përmbajtjen dhe stilin e pikturës pompeiane të gjendur në vilat e qytetit Pompei.

Teza VIII

- a) Përmendni disa nga veprat më të rëndësishme të Rembrandit. Çfarë e bën të dallueshme veprën e Rembrandit? Komentoni shkurt rreth jetës së tij.
- b) Cili është autori i tabllës “*Dasma Shkodrane*”? Analizoni këtë vepër? Citoni një vepër tjetër po të këtij autori.
- c) Çfarë dini mbi artin në hapësirën publike?

Teza IX

- a) Citoni emrat e pesë piktorëve të shquar spanjollë. Flisni më gjerë për njërin prej tyre.
- b) Cilët janë tre autorët e monumentit të Skënderbeut që ndodhet në sheshin e Tiranës?
- c) Flisni mbi një muze apo galeri që keni vizituar.

Teza X

- a) Flisni mbi prirjet dhe autorët e Neoklasicizmit. Cili është autori i tabllës “*Marati i vrarë*”? Flisni mbi të ose mbi ndonjë vepër tjetër të tij.
- b) Citoni tre ikonografë të shquar Shqiptarë. Citoni disa qytete në Shqipëri që kanë Muze Arkeologjik.
- c) Përmendni disa nga teknikat e pikturës monumentale.

Teza XI

- a)** Flisni mbi prirjet e rrymës së Romantizmit. Citoni dhe komentoni ndonjë autor dhe vepër të rëndësishme të kësaj rryme artistike. (C. D. Friedrich, E. Delakrua, T. Zheriko, J. Turner, etj.)
- b)** Analizoni krijimtarinë e artistit Sali Shijaku. Komentoni ndonjë vepër të njohur të tij.
- c)** Flisni rreth tipareve të teknikës së afreskut në aspektet e destinacionit, përmbajtjes dhe formës si stil e teknikë.

Teza XII

- a)** Përse Impresionizmi konsiderohet një dukuri e rëndësishme në historinë e artit? Pse u quajt Impresionizëm? Citoni emrat e tre autorëve impresionistë.
- b)** Citoni një amfiteatër që gjendet në Shqipëri. Si ishte i ndërtuar dhe përse shërbente një amfiteatër?
- c)** Çfarë është instalacioni? A mund ta përshkruani se si dhe me çfarë operon ky medium? A mund të flisni mbi Arte Povera?

Teza XIII

- a)** Flisni mbi pararojat artistike të shekullit të njëzetë. Ndaluni më hollësisht në njërin syresh (Abstraktizmi, Kubizmi, Futurizmi).
- b)** A mund të flisni mbi mozaikun “Bukuroshja e Durrësit”? Ku gjendet ai sot?
- c)** Flisni mbi krijimtarinë e piktorit Danish Jukniu ose të ndonjë bashkëkohësi të tij.

Teza XIV

- a)** Flisni çfarë dini mbi Dadaizmin dhe Surrealizmin? Çfarë sollën në fushën e kërkimit artistik këto lëvizje? A mund të shpjegoni domethënien e termave ready made dhe automatizmi psikik? Kush janë përfaqësuesit më të spikatur të tyre? Përmendni titujt e ndonjë vepre të tyre dhe analizoni atë.
- b)** Citoni emrin e një piktori anglez që ka udhëtar në Shqipëri dhe ka pikturuar peisazhin shqiptar dhe motivet shqiptare.
- c)** Ç’është Ikona? Çfarë dini mbi përmbajtjen dhe rregullat dhe teknikën e realizimit të saj?

Teza XV

- a)** Çfarë dini mbi Pikturën murale meksikane të Diego Riveras e Daniele Orozcos, dhe qasjen e tyre politike / Flisni mbi artistin modern Marc Chagall dhe mbi veprat monumentale të tij.
- b)** Në cilin qytet të Shqipërisë gjendet muzeu “Onufri”? Çfarë përmban ky muze?
- c)** A mund të përcaktoni disa teknika të pikturës së aplikuar nëse janë të përshtatshme për interior apo eksterier?

Teza XVI

- a) Çfarë është Grafizmi (Basquiat, Haring, etj.)?
- b) Përshkruani disa teknika të grafikës së realizuar nga autorë shqiptarë.
- c) Flisni mbi teknikat e vitrazhit dhe të risisë së saj në Mesjetën Gotike. Flisni rreth tipareve të kësaj teknike artistike në aspektet e destinacionit, përmbajtjes dhe formës si stil e teknikë.

Bibliografi

- Ernst H. Gombrich, *Historia e Artit*, 1996.
- Rozela Dhimgjini, *Momente të Historisë së Artit nga Rilindja deri në shek. XX*, 2016.
- Ermir Hoxha, *Historia e Artit Shqiptar 1858 -2000*, 2019
- De Vecchi, Cerchiari, *Kohët e artit*, vëll. I, II.
- Zef Paci, *Marubi, objektivi i lëvizshëm i një arkivi*, 2014.